



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 774 Prot

Tiranë më 23/12 /2021

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014, shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e punës Valltar/e në Drejtorinë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

❖ Valltar (djalë) - 1 (një) vend

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOB nxjerrë njoftimin e saj 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Njoftojmë të gjithë të interesuarit se në datën **22/02/2022 ora 11:00** në **Sallën e Baletit të Ansambilit Popullor**, në katin e tretë brenda ambienteve të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor do të zhvillohet audicioni për vendin vakant Valltar/e në Sektorin e Valleve në Drejtorinë e Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

Të gjithë ata artistë të jashtëm të interesuar për pjesmarrje për këtë vend vakant duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP deri me datë 15/02/2022 ora 14:00 dokumentat e nevojshme për regjistrim si më poshtë vijon;

1. Të ketë kryer studimet e mesme ose të larta në degën Balet ose Koreografi (bachelor ose master);
2. Diplomë e përfundimit të shkollës së mesme ose të lartë dhe listë notash të noterizuara;
3. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
4. CV bashkangjitur me Foto;
5. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria e 2 viteve të fundit e çertifikuar, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, eksperiencë pune për figurën artistike që konkurojnë, etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter.

Kriteret e veçanta të kualifikimit për vendin vakant: Valltar/e (femra dhe meshkuj) si vijon:

Konkurimi personal:

Konkurenti duhet të jetë brenda normave fizike referuar tabelës së Profesor Doktor D.J Robinson (bashkëngjitur njoftimit.)

- ❖ Ushtrime klasike (Leve, në mes të sallës);
- ❖ Riprodhim i një motivi me shikim të parë;
- ❖ Demonstrim i një valleje popullore të përzgjedhur nga vetë konkurenti. (maksimumi 2.5 minuta, por jo më pak se 1 minutë);
- ❖ Demonstrim i motiveve popullore të zonës së Jugut, Veriut dhe Shqipërisë së Mesme.

Demonstrim i detyrueshëm për çdo konkurrent;

- ❖ Finalja e valles “Në Gare” (në çift) – kjo për të parë aftësinë komunikuese me partneren/in, kiminë mes çiftit si dhe njëkohësisht fokus në teknikën e vështirë të kësaj valleje.
- ❖ Finalja e valles “Barinjte e Korabit” (vetëm djemtë)

Sqarim: Çdo konkurent i interesuar mund të paraqesë kërkesë pranë Institucionit për trajnim me trupën e valleve të Ansamblit Popullor, për vallet e detyruara “Në Garë” “Barinjte e Korabit”. Trajnimi do të behet brenda afatit kohor 15.01.2022 deri në 03.02.2022.

Punoj kriteret e përgjithshme: Juriste Migena BIBA

Pranoi: Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Aida GEGAJ

Konceptoi artistikisht: Mjeshtër i Valles Genc KASTRATI;

Valltar Gëzim HALILI;

Valltare Helga SARAJI;

Pranoi; Drejtori Artistik Sokol MARSJ

MIRATOI

DREJTORE E PËRGJITHSHME



MESHKUJ

Gjatesi	Peshe	Gjatesi	Peshe	Gjatesi	Peshe	Gjatesi	Peshe	Gjatesi	Peshe	Gjatesi	Peshe	Gjatesi	Peshe
160 cm	57,19 kg	165 cm	60,83 kg	170 cm	64,47 kg	175 cm	68,11 kg	180 cm	71,75 kg	185 cm	75,39 kg		
161 cm	57,91 kg	166 cm	61,56 kg	171 cm	65,20 kg	176 cm	68,84 kg	181 cm	72,48 kg	186 cm	76,12 kg		
162 cm	58,64 kg	167 cm	62,28 kg	172 cm	65,93 kg	177 cm	69,57 kg	182 cm	73,21 kg	187 cm	76,85 kg		
163 cm	59,37 kg	168 cm	63,01 kg	173 cm	66,65 kg	178 cm	70,30 kg	183 cm	73,94 kg	188 cm	77,58 kg		
164 cm	60,10 kg	169 cm	63,74 kg	174 cm	67,38 kg	179 cm	71,02 kg	184 cm	74,67 kg	189 cm	78,31 kg		

Formula e perdorur eshte ne baze te **Dr. J. D. Robinson**

(Femra) **Formula e Robinson e perdorur ne kete tabelë = 48,67 kg + 1,65 kg per cdo 2,54cm mbi 1,524 M**

(Meshkuj) **Formula e Robinson e perdorur ne kete tabelë = 51,65 kg + 1,85 kg per cdo 2,54cm mbi 1,524 M**